

Titulli i lëndës:	KONSTRUKSIONET ARKITEKTONIKE 3
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs është një hyrje intensive për disiplinën e konstruksioneve arkitektonike dhe njohurive relevante drejt të kuptuarit të konceptit, elementeve dhe tërësisë së konstruksionit të objekteve arkitektonike. Lënda zhvillohet nëpërmjet mësimve teorike dhe praktike, përmbajtja e të cilave fillimisht bëhet nga temat e sistemeve konstruktive të komunikimit vertikal, hapjeve arkitektonike dhe tipologjive të dyshemeve, me njësi metodike, si: shkallët, ashensorët, eskalatorët, dyert, dritaret, fasadat, etj.
Qëllimet e lëndës:	Përgatitja themelore për të kuptuar dhe prezantuar konceptin, elementët dhe tërësinë e konstruksionit të elementëve konstruktiv arkitektonik. Përkatësisht zhvillimin e aftësive për të menduar projektimin dhe realizimin e sistemit dhe të elementëve të konstruksionit, në harmoni me materialet relevante dhe në kontest me nevojat për hartimin dhe artikullimin e planeve zbatuese arkitektonike – ndërtimore dhe urbane.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> - të njohohen me përmbajtjen kryesore të konstruksionit të elementëve arkitektonik dhe zbatimin e tyre, në mënyrë që t'i bëjë ata të aftë të projektojnë dhe të propozojnë elementin konstruktiv (shkallët, ashensorët, eskalatorët, dyert, dritaret, etj., sipas planeve zbatuese arkitektonike e ndërtimore. - të njohohen për aplikueshmërinë e standardeve dhe kodeve të ndërtimit - të aftësohen për të menduar mënyrë konstruktive gjatë sajimit të planeve zbatuese, - të aftësohen në lëmin e infografikës për projektet arkitektonike - të aftësohen për aplikueshmërinë e projekteve arkitektonike dhe konstruksioneve të qëndrueshme.
Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata / Leksione teorike Ushtrime praktike – punimin e grafikëve dhe diagrameve, eventualisht modeleve, të elementëve arkitektonike e konstruktive, sipas njësisë mësimore.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e studentëve 10%, Puna hulumtuese (shkrimi dhe prezantimi) 15+15=30%, Puna seminarike (projekti dhe prezantimi) 15+15=30%, dhe Provimi përfundimtar (2 teste teorike) 15+15=30%. Studentët kanë të drejtë të vlerësohen në provim përfundimtar vetëm nëse kanë përfunduar me sukses punën hulumtuese dhe seminarike.
Literatura primare:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Violeta Nushi</i>, Ligjëratat të Prezantimet, përditësuara çdo vit akademik 2. <i>Ilia Papanikolla</i>, Konstruksionet arkitektonike 3. <i>D.K. Ching and Cassandra Adams</i>, Building construction, Third edition 4. <i>Djuro Peulic</i>, Konstruktivni elementi zgrada 1dhe 2
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i>, Baukonstruktionslehre 1 2. <i>Karl Knöll, Dietrich Neumann, Von Otto Frick</i>, Baukonstruktionslehre 2